



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

PËR DEKLARIMIN
TË PËRFUNDUAR DHE PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË SHQYRTIMIT TË REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT
TË PËRGJITHSHËM PËR ISH-FUNKSIONARIN PUBLIK Z. ANDRIN MARK QEHAJA, NË
ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE
QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu III, pika 3, germa “ç” e Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 3244/51 prot., datë 08.10.2020, me lëndë “Dërgohet “Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues Andrin Mark Qehaja, këshilltar në Këshillin Bashkiak Tropojë,

VËREN

I.

- a) Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:
- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
 - Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
 - Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
 - Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.
- b) Z. Andrin Mark Qehaja, si kandidat i listës shumë-mërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Formularin e Vetëdeklarimit më datë 13.05.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3615 prot datë 15.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 3617 prot. datë 15.05.2019, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
 - ii. Me shkresën nr. V-1512/1 prot. datë 16.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues z. Andrin Mark Qehaja figuron me statusin "I padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - iii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka paraqitur të dhënat personale per subjektin deklarues z. Andrin Mark Qehaja.
 - iv. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 561 datë 18.05.2019 ka vendosur të njoftojë KZAZ nr. 09 të vijojë procedurat për regjistrimin e listës shumëmeërore.
- c) Më datë 10.10.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftohet me shkresën nr. 2853 prot. për krijimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, si pasojë e dorëheqjes se anëtarit të këshillit bashkiak z. Abedin Kërnaja, i propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.
- ç) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe nenit 164 të Kodit Zgjedhor, ka njoftuar me shkresën nr. 14536/1 datë 15.10.2019, z. Andrin Qehaja të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit si kandidati i rradhës të cilit i takon mandati për anëtar në këshillin bashkiak Tropojë, Qarku Kukës.
- i. Më datë 29.10.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", subjekti vetëdeklarues ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Formularin e Vetëdeklarimit me numër 13690/1 unik.
 - ii. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për kandidatin për anëtar këshilli bashkiak ku rezultuan se subjekti ka deklaruar të njëjta të dhëna si në momentin e kandidimit.
 - iii. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresat nr. 14746 prot. datë 05.11.2019 dhe nr. 14747 prot. datë 05.11.2019, ka kërkuar përkatësisht informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Me shkresën nr. 8966/1 prot. datë 06.12.2019 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka paraqitur të dhënat personale per subjektin deklarues z. Andrin Mark Qehaja. Referuar këtyre të dhënave rezulton se subjekti nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
 - iv. Me shkresën nr. V-3339/1 prot. datë 11.11.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues z. Andrin Mark Qehaja figuron me statusin "I padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - v. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1102, datë 06.12.2019, vërejtë se nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjidhshmërisë dhe vendosi të njoftojë këshillin bashkiak Tropojë të vijojë procedurat e mëtejshme për dhënien e mandatit.

II.

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të detyrave të përcaktuara në paragrafin "ç", pika 3 e Kreu V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për shkak të deklarimit të të dhënave për dëbim nga territori i një shteti anëtar i BE-së, me shkresën nr. 14870 prot., datë 11.12.2019 ka përcjellë të



dhënat e administruara nga KQZ për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin deklarues z. Andrin Mark Qehaja, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë, Qarku Kukës.

- b) Me shkresën nr. 3244/51 ex + 19 prot., datë 08.10.2020, Prokurori i Përgjithshëm, Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë Drejtorisë së Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin z. Andrin Mark Qehaja, me funksion Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tropojë.
- c) Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin z. Andrin Mark Qehaja me funksion Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tropojë” rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve të ndryshme për verifikim të mëtejshëm:
- i. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. V-3801/1 prot., datë 19.12.2019 ka vënë në dispozicion të Prokurorisë së Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 18.12.2019, sipas të cilës rezulton se z. Andrin Mark Qehaja, figuron “I Padënuar” brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - ii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10232/1 prot., datë 30.12.2019, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit z. Andrin Mark Qehaja, sipas Regjistrisë Kombëtare të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se Këshilltari i Këshillit të Bashkisë Tropojë, z. Andrin Mark Qehaja, nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
 - iii. Nga informacioni i përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme, nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Prokuroritë e Apelit dhe Apeleve dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se ndaj subjektit z. Andrin Mark Qehaja nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qënë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.
 - iv. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit deklaron se z. Andrin Mark Qehaja nuk ka qënë i ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë vepre penale. Nuk ka gjeneralitete të tjera të regjistruara, përveç sa ka deklaruar.
 - v. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme përgjigjen se sipas autoriteteve kompetente greke, shtetasi i mësipërm është arrestuar më datë 08.02.2010 nga Departamenti i Policisë të N.Filadelfeias/Greqi për shkelje të ligjit për të huajt. Sipas të dhënave në databazet e tyre nuk është lëshuar asnjë urdhër arresti për këtë shtetas. Nga verifikimi rezulton se z. Andrin Mark Qehaja nuk është në arkiven e ZQK interpol Tirana, pra nuk ka të dhëna për këtë status.
 - vi. Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme në sistemin TIMS, rezulton se z. Andrin Mark Qehaja, ka të njëjtat gjeneralitete të cilat i ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit. Në sistem rezulton se ky stetas është i deportuar në datë 08.11.2008 nga pika kufitare Kakavije.
 - vii. Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 1687/3 prot., datë 21.09.2020, ka përcjellë përkthimin e akteve nga Autoritetet e Drejtësisë së Republikës së Greqisë, në lidhje me z. Andrin Mark Qehaja. Rezulton se :



- Ministria e Drejtësisë së Republikë së Greqisë, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Drejtësisë, Mardhënieve Ndërkombëtare Juridike dhe të Drejtave të Njeriut, Departamenti i Regjistrimit Penal & Dhënies së Amnistisë Athinë (01/01), me numër protokollit 123061 datë 02.06.2020, ka përcjellë kopjen e regjistrimit penal për përdorim juridik.
- Departamenti i Regjistrimit Penal dhe Dhënies së Amnistisë, për z. Andrin Mark Qehaja, vërtetohet se gjendja penale e z. Andrin Mark Qehaja, sipas të dhënave të Sistemit të Integruar Informativ të Regjistrimit Penal Kombëtar janë “ZERO”.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Atikës, Drejtoria e të Huajve, Zyra e Rrjedhjes së Migracionit informojnë se z. Andrin Mark Qehaja, u arrestua më datë 21.10.2008 për shkelje të nenit nr. 76 paragrafi parë të ligjit nr. 3386/05 “Për të Huajt” duke pasur në posedim të tij pasaportën shqiptare me numër Z0175183/ 20-09-2002 dhe më 07/11/2008 ai u deportua në Shqipëri përmes Postës së Policisë Kakavijë.
- Përvec kësaj, ai u arrestua më 08/02/2010, fillimisht për shkeljen e ligjit L33862/ 2005 “Për të huajt”, nr. 82 par. 4, me Vendimin numër 13561/ 10- Vendim i Gjykatës Treanëtarëshe të Fajit të Athinës dhe më pas, më 11/02/2010 për shkeljen e ligjit nr. 76, par. I të Ligjit 3386/05 “Për të huajt”. Më 30.08.2010, ai u la i lirë me nr. 1152/30.08.10, Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të Athinës për tu larguar vetë nga vendi brenda 30 ditësh.

III.

- a) Referuar neneve 33, 42, 47 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Andrin Mark Qehaja, për të dhënë mendime dhe shpjegime për faktet dhe rrethanat e çështjes.
- i. Më datë 20.10.2020, z. Andrin Mark Qehaja, është njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së me anë të komunikimit telefonik për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, i cili ka kërkuar kohë për zhvillimin e seancës, dhe ka konfirmuar datën 22.10.2020 ora 12:30 për të dhënë shpjegime në lidhje me rezultatet e verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme. Njoftimi u afishua edhe në ambientet publike të KQZ.
 - ii. Më datë 22.10.2020, ora 12:30, në seancën dëgjimore në prani të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së dhe përfaqësuesve të Drejtorisë Juridike, z. Andrin Mark Qehaja u paraqit së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor z. Besnik Spahiu, të cilin e konfirmoi si përfaqësuesin e tij ligjor në këtë seancë.
 - iii. Z. Andrin Mark Qehaja dhe përfaqësuesi i tij kërkuan shtyrje të seancës dëgjimore me qëllim njohjen me dokumentacionin e dosjes dhe rezultatet e verifikimit të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme.
 - iv. Seanca e dëgjimore e rradhës u caktua të zhvillohej me datë 27.10.2020 ora 12:00.
 - v. Me shkresën nr. 1717 prot. datë 23.10.2020, z. Andrin Mark Qehaja, ka depozituar dorëheqjen e tij nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak.
 - vi. Në seancën dëgjimore të datës 27.10.2020 ora 12:00, z. Andrin Mark Qehaja u përfaqësua në seancë nga përfaqësuesi i tij ligjor z. Besnik Spahiu, i cili deklaroi se z. Andrin Qehaja ka dhënë dorëheqjen si anëtar i këshillit bashkiak.

Referuar paragrafit 2 dhe 3 të nenit 90 dhe nenit 95 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është në diskrecionin e organit publik të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur. Në kushtet e dorëheqjes së subjektit deklarues ndodhemi në kushtet e



parashikuara nga neni 95 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe,

PËR KËTO ARSYE:


Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2, i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, paragrafi 2 dhe 3 i nenit 90 dhe neni 95 i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSA:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për shkak të dorëheqjes të z. Andrin Mark Qehaja nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak Tropojë, Qarku Kukës.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI



Nr. 12 i vendimit

Data 27.10.2020 e vendimit

“Për deklarimin të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të procedurës administrative të shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për ish-funksionarin publik z. Andrin Mark Qehaja, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

